LIGJ
Nr.10 058, datë 22.1.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA"

Në mbështetje të neneve 10 pika 5, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6034, datë 29.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË NDËRSJELLA

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane, bazuar në parimet e lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit fetar, të sanksionuara e garantuara në nenet 10 e 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, si dhe në ligjet e tjera në fuqi (më poshtë sipas rastit do të citohen Kushtetuta, ligjet dhe/ose legjislacioni në fuqi), lidhin marrëveshjen si më poshtë (më poshtë do të citohet "Marrëveshja").

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo Marrëveshje rregullon çështje të marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit midis shtetit shqiptar dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane në të mirë të secilit dhe të të gjithëve, mbi

bazën e parimeve kushtetuese që garantojnë lirinë e shfaqjes dhe të ushtrimit të besimit fetar, si dhe të dëshirës së përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar marrëdhëniet e ndërsjella.

Neni 2
Kuptimi

Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe organizimi i individëve që shfaqin e shprehin të njëjtat bindje e besime fetare dhe janë të regjistruar në regjistrat përkatës të bashkësive.

Neni 3
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është:

a) të garantojë realizimin e të drejtave të sanksionuara nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi në lidhje me lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë;

b) të njohë e të garantojë respektimin e të drejtave të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, të institucioneve dhe strukturave të saj, si dhe të personave juridikë të themeluar prej saj, për të zhvilluar lirisht misionin e saj fetar, edukativ, bamirës;

c) të njohë dhe të garantojë paprekshmërinë e institucioneve të kultit, për aq sa veprimtaria e tyre nuk vjen në kundërshtim me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, si dhe me Kushtetutën e ligjet në fuqi;

d) të garantojë lirinë e individit për të zgjedhur ose ndryshuar fenë, për ta shfaqur atë individualisht ose kolektivisht në institucionet fetare ose jashtë tyre, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve fetare;

e) të sigurojë lirinë e individit për të mos u ndaluar dhe as detyruar të bëjë pjesë në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, ose të marrë pjesë në praktikat, ritet dhe në strukturat drejtuese të saj.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, palët angazhohen në sigurimin e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë. Kjo liri nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato që, të parashikuara me ligj, përbëjnë masat e nevojshme në një shoqëri demokratike, për sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit, të shtetit, të shëndetit e moralit publik, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 4
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje i shtrin efektet mbi të gjitha organet dhe institucionet shtetërore që kanë të bëjnë me fenë, Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, si dhe me institucionet dhe personat juridikë të themeluar prej Kryegjyshatës Botërore Bektashiane.

2. Individët ose grupimet e tyre përfitojnë nga të drejtat e parashikuara nga kjo Marrëveshje, kur marrin pjesë në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane ose në praktikat e saj.

Neni 5
Parime të përgjithshme

1. Shteti respekton dhe mbron bashkëjetesën fetare.

2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të organizohet dhe të realizojë misionin e saj në mënyrë të pavarur nga shteti, duke respektuar parimin e laicitetit të shtetit, Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Neni 6
Bashkërendimi me organet shtetërore

1. Komiteti Shtetëror për Kultet përfaqëson shtetin në marrëdhëniet e ndërsjella me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, e cila bashkëpunon me Komitetin për realizimin e komunikimit aktiv të bashkësisë me organet dhe institucionet shtetërore.

2. Në marrëdhëniet me organet dhe institucionet shtetërore, Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfaqësohet nga organet e caktuara prej saj, si dhe përdor vulën dhe shenjat e saj identifikuese.

KREU II
ORGANIZIMI DHE PERSONALITETI JURIDIK I BASHKËSISË FETARE

Neni 7
Bashkësia fetare dhe personat juridikë

1. Shteti njeh dhe respekton personalitetin juridik të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këtë Marrëveshje, si edhe të gjitha veprimet e deritanishme të kryera prej saj, për aq sa ato nuk vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislacionin.

2. Shteti shqiptar njeh dhe mbron të drejtat e veprimtarisë së Kryegjyshatës Botërore Bektashiane.

3. Kryegjyshata Botërore Bektashiane e ka selinë në Tiranë, kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë.

4. Kryegjyshata Botërore Bektashiane është organizuar në bazë të statutit të saj, miratuar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ajo ka degët e saj brenda dhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të cilat drejtohen nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, kreu i së cilës është Kryegjyshi Botëror.

5. Themelimi, struktura, organizimi, objekti i veprimtarisë, administrimi, rregullimi dhe mbarimi i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane si person juridik realizohen në përputhje me rregullat e traditat e Kryegjyshatës, me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.

6. Shteti i njeh Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të drejtën për të krijuar institucione e struktura me karakter fetar ose jofetar, të cilat e fitojnë ose e kanë statusin e personit juridik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Institucionet e strukturat e krijuara nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie shoqërore, arsimore, shëndetësore e ekonomike, në përputhje me rregullat e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, si dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon ndërmjet të tjerave edhe me pajisjen me licenca dhe lejet përkatëse.

8. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, me vullnetin e saj të lirë, mund të krijojë bashkime fetare, nëpërmjet bashkimit të dy ose më shumë bashkësive, me qëllim që të realizohen synimet e përbashkëta. Këto bashkime, edhe nëse nuk regjistrohen si persona juridikë, njihen nga shteti pas depozitimit të aktmarrëveshjes për krijimin e tyre, në Komitetin Shtetëror për Kultet.

9. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, si dhe organizatat e tjera që krijon për ushtrimin e veprimtarisë së saj, në të gjitha format e ligjshme të organizimit të tyre, janë persona juridikë jofitimprurës.

Neni 8

Personaliteti juridik i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane

1. Kryegjyshata Botërore Bektashiane njihet si person juridik me vendim të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesa për regjistrimin e personit juridik, paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane;

b) Akti i themelimit të personit juridik, i firmosur nga përfaqësuesi ligjor i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, sipas rregullave të saj, ku, ndërmjet të tjerave, përcaktohen selia, natyra dhe objekti i veprimtarisë.

c) Statuti i personit juridik, sipas rregullave të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, ku, ndërmjet të tjerave, përcaktohen struktura e organizimit të Kryegjyshatës, organet, drejtuesit dhe funksionarët, si dhe mënyra e emërimit dhe e zgjedhjes së tyre, përfaqësuesit ligjorë të saj, detyrat dhe kompetencat përkatëse, burimet e financimit dhe mënyrat e mbarimit të personit juridik.

d) Mendimi i dhënë nga Komiteti Shtetëror për Kultet, i cili konfirmon njohjen e misionit fetar të kërkuesit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, të shoqëruar me dokumentet e sipërpërmendura, bën njohjen e personit juridik dhe regjistrimin e tij, nëpërmjet vendimit përkatës.

Neni 9

Afati dhe territori i veprimtarisë së personave juridikë të bashkësisë fetare

Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe personat juridikë të krijuar prej saj, mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre me afat të pakufizuar, në një pjesë ose në të gjithë territorin, si dhe për ushtrimin e lirisë së besimit të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, sipas përzgjedhjes së vetë bashkësisë.

Kryegjyshata Botërore Bektashiane pranon detyrimin e rregulluar me statutin e saj dhe rregulloren e brendshme që brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, shërbesat fetare të kryhen në gjuhën shqipe, si dhe titullarët e zgjedhur për drejtimin e bashkësisë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të jenë me kombësi shqiptare dhe me moral atdhedashës.

Neni 10

Parimet e organizimit dhe të veprimtarisë së Kryegjyshatës Botërore Bektashiane

1. Palët angazhohen për respektimin e parimeve kushtetuese mbi të cilat ndërtohet kjo Marrëveshje dhe do të punojnë së bashku me zbatimin e legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Shteti respekton pavarësinë e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane për t'u organizuar e ushtruar veprimtarinë e saj, si dhe për të administruar pasuritë që zotëron, në bazë të parimeve, rregullave, traditave (kanoneve) dhe statutit të saj.

3. Parimet, rregullat, kanonet dhe statuti i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe veprimtaria e saj respektojnë interesat kombëtarë, bashkëjetesën dhe tolerancën fetare ndërmjet bashkësive fetare në Shqipëri.

Neni 11

Organizimi i Kryegjyshatës Botërore Bektashiane

1. Në marrëdhëniet me organet, institucionet dhe organizatat e tjera laike e fetare, brenda dhe jashtë vendit, besimtarët e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane përfaqësohen nga organet, funksionarët dhe drejtuesit e formuar, të emëruar a zgjedhur në përputhje me statutin.

2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të formojë organet e saj, të emërojë funksionarët dhe drejtuesit në mënyrë të pavarur, në përputhje me dispozitat e parashikuara në

statutin e saj. Titullari i Kryegjyshatës caktohet sipas procedurave dhe kritereve të parashikuara në statutin e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane.

3. Përpara shpalljes publike të titullarit të caktuar, si dhe të ndryshimeve në strukturat e saj drejtuese, Kryegjyshata Botërore Bektashiane njofton Komitetin Shtetëror për Kultet.

4. Funksionarëve, drejtuesve dhe organeve të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane u garantohet liri e plotë e ushtrimit të veprimtarisë fetare, organizative e administrative, në përputhje me aktet e Kryegjyshatës, për aq sa kjo veprimtari nuk vjen në kundërshtim me rendin kushtetues dhe ligjor.

Neni 12
Marrëdhëniet me bashkësitë e huaja fetare

1. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të krijojë dhe të mbajë kontakte me bashkësi fetare të një vendi tjetër ose ndërkombëtare, të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre fetare e bamirëse, për aq sa këto kontakte nuk bien ndesh me rendin e brendshëm kushtetues.

2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të përfitojnë mbështetje financiare dhe/ose materiale nga entitete dhe/ose individë të huaj, për aq sa kjo mbështetje nuk bie ndesh me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi.

KREU III
STATUTI FINANCIAR

Neni 13
Mbështetja financiare ose materiale shtetërore

1. Shteti shqiptar mund t'i japë Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, apo subjekteve juridike të themeluara prej saj, mbështetje financiare ose materiale.

2. Modalitetet dhe kriteret për sigurimin e kësaj mbështetjeje financiare duhet të përcaktohen me një ligj specifik për mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit për kultet fetare.

Neni 14
Regjistrimi në organet tatimore

Kryegjyshata Botërore Betkashiane, si dhe personat e saj juridikë, duhet të regjistrohen në organet tatimore, sikurse çdo person juridik jofitimprurës, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 15
Statusi juridik dhe fiskal

1. Personat juridikë të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane përmbushin të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara për të gjitha personat juridikë jofitimprurës.

2. Përjashtohen nga të gjitha llojet e taksave:

a) Subvencionet financiare të çfarëdolloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si edhe donacionet materiale të destinuara për të realizuar misionin e vet, kur këto të ardhura apo donacione nuk përdoren për përfitime nga organizatorët.

b) Ndërtimi i objekteve të reja, ndërtesat në pronësi ose në përdorim të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, ose të personave juridikë të themeluar prej saj të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore, në rastet kur ato përdoren pa qëllim fitimi për ushtrimin e

besimit, drejtimin dhe administrimin fetar, veprimtarinë baritore, humanitare e bamirëse, formimin e klerikëve, mësimin e teologjisë dhe shkencave të tjera fetare, si dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane.

c) Taksa e trashëgimisë ose e kalimit të pasurisë në procesin e regjistrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat i dhurohen Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, ose kur ato kalojnë mes entiteteve të vetë Komunitetit Bektashian.

3. Personat juridikë të themeluar nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane, por që nuk e kanë zotësinë juridike ose nuk janë regjistruar si organizata jofitimprurëse përpara ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën që të regjistrohen në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, brenda dy vjetëve nga dita e hyrjes së saj në fuqi.

4. Përjashtohen nga detyrimi i derdhjes së kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor personeli fetar dhe laik në shërbim të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, me kombësi të huaj, me banim të rregullt në Shqipëri, të cilët nuk përfitojnë asnjë të ardhur apo shpërblim për kryerjen e veprimtarisë së tyre dhe që i kanë derdhur këto kontribute në vendet e origjinës.

5. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, për personelin klerik dhe laik të saj, si kategori profesionale krejt e veçantë, ka të drejtë shkallëzimin e diferencuar për nivelin e pagës, për efekt kontributesh të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat e personit.

6. Për veprimtaritë me karakter institucional, si: ushtrimi i kultit, drejtimi dhe administrimi i komunitetit, veprimtaria fetare, humanitare dhe bamirëse, formimi i klerit, mësimi i teologjisë dhe i shkencave fetare, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe personat juridikë të themeluar prej saj nuk janë të detyruar të mbajnë regjistër kontabël dhe t'u nënshtrohen standardeve administrative të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë çështje. Si pasojë, për të tilla veprimtari ato nuk e kanë detyrim që të paraqesin bilancin kontabël vjetor tek organet kompetente shtetërore dhe as ta depozitojnë atë pranë organizmave shtetërorë të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

KREU IV
BASHKËPUNIMI NË TË MIRË TË SHTETASVE

Neni 16
Festat fetare

1. Ditët e festave fetare që do të jenë ditë pushimi vendosen me ligj. Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të propozojnë festa fetare, që sipas mendimit të saj, mund të shpallen ditë pushimi.

2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane, në përputhje me nevojat fetare të besimtarëve, kanë të drejtë të përcaktojnë edhe festa të tjera veç atyre që do të trajtohen me ligj si festa zyrtare, të cilat nuk janë të detyrueshme për sektorin shtetëror publik dhe privat.

Neni 17
Institucionet edukative dhe arsimore të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane

1. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë, në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të ngrejë dhe të administrojë institucione edukative dhe arsimore të të gjitha niveleve.

2. Shteti dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane angazhohen të garantojnë të drejtën e individëve për t'u arsimuar pa asnjë dallim, përfshirë edhe arsimin fetar, duke respektuar të drejtën e prindërve për të siguruar edukimin e fëmijëve në përputhje me bindjet e tyre.

3. Shteti e njeh vlefshmërinë e dokumenteve të lëshuara nga institucionet arsimore fetare,

sipas kritereve të caktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin.

4. Gjatë procesit mësimdhënës shteti dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane angazhohen që arsimi i fëmijëve të bazohet mbi të drejtat e njeriut dhe parimet demokratike, të drejtohet në përgatitjen e fëmijëve për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe vëllazërisë midis njerëzve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare, ose personave me origjinë tjetër, duke iu kundërvënë racizmit e fanatizmit.

Neni 18

Kryerja e veprimtarive sociale

Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të ushtrojë veprimtari sociale me karakter ekonomik, edukativ e shëndetësor. Kjo e drejtë përfshin edhe krijimin e mjediseve sociale të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 19

Organizatat bamirëse

Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të themelojë organizata bamirëse, duke respektuar rregullat e përgjithshme dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 20

Liria e shprehjes dhe e drejta për informim

1. Shteti dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane njohin dhe pranojnë mjetet e informimit publik si një element të rëndësishëm për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të ndërgjegjes.

2. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të shprehë dhe të përhapë lirisht bindjet e saj nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik, medias së shkruar dhe asaj pamore, si dhe në çfarëdo forme tjetër të njohur ose që do të njihet në të ardhmen.

3. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të themelojë struktura të komunikimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, përmbajtja që jepet përmes mjeteve të komunikimit masiv nuk duhet të përshkohet nga ide që cenojnë rendin kushtetues, tolerancën fetare, ose që diskriminojnë bashkësitë fetare dhe nxisin grindje ndërfetare.

4. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka të drejtë të shprehet nëpërmjet mjeteve të komunikimit dhe informimit publik.

5. Komiteti Shtetëror për Kultet bashkëpunon me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane për nevoja studimore e informuese.

Neni 21

Objektet e kultit

1. Ndërtesat dhe objektet që shërbejnë për kryerjen e ceremonive fetare konsiderohen të shenjta nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane. Ndërhyrja e autoriteteve shtetërore në to është e ndaluar, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet në zbatim të një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv, ose në rast të kanosjes së një rreziku të afërm.

2. Paprekshmëria e hapësirës publike garantohet nga shteti.

3. Organet kompetente shtetërore, në bashkëpunim me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, përcaktojnë vendin për ndërtimin e objekteve të reja të kultit dhe vendosjen e simboleve fetare, në përputhje me planet rregulluese urbanistike dhe kriteret që parashikon ligji “Për urbanistikën”.

KREU V
ÇËSHTJET E PRONËSISË

Neni 22
E drejta e pronës

1. Shteti i njeh Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të drejtën e pronës mbi sende të luajtshme dhe të paluajtshme.

2. Shteti do t'i kthejë dhe kompensojë Kryegjyshatës Botërore Bektashiane të gjitha pronat, me përparësi objektet e kultit tashmë të njohura nga të gjithë, të cilat kanë qenë për shekuj qendra shpirtërore dhe kulturore të komunitetit bektashian dhe përbëjnë historinë e këtij komuniteti, si objektet e kultit, vendet e shenjta, sendet e kultit dhe arkivat e saj të konfiskuara nga regjimi komunist.

3. Në rastet kur objektet e kultit të Komunitetit Bektashian nuk gjenden të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronësinë do ta vërtetojë (provojë) nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit.

Neni 23
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore fetare

1. Republika e Shqipërisë njeh trashëgiminë morale dhe pasurore të besimit bektashian.

2. Objektet e kultit që kanë statusin e monumentit të kulturës, i kthehen në pronësi dhe përdorim Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe për çdo ndërhyrje të mundshme që do të bëjë Instituti i Monumenteve të Kulturës të bashkëpunojë me të.

3. Shteti mund të marrë në përdorim një objekt të kultit vetëm për nevoja e interesa madhorë dhe vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht pëlqimin e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane.

4. Këshilli i Ministrave, duke u bazuar edhe në mendimin e bashkësisë, bashkërendon përpjekjet në të ardhmen për të evidentuar, vlerësuar e mbrojtur pasuritë kulturore, si dhe godinat e kultit të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, të cilat bartin vlera të kulturës kombëtare materiale e shpirtërore.

5. Shteti lejon ushtrimin e veprimtarisë fetare në një objekt të kultit që është trashëgimi kulturore kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, si dhe zgjidhja e çështjeve të diskutueshme bëhen mbi bazën e mirëkuptimit midis palëve.

2. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me mirëkuptim midis palëve.

3. Për të gjitha çështjet e përbashkëta në të cilat do të ketë mendime të ndryshme, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të gjejnë një qëndrim të njëjtë, duke pranuar ndërmjetësimin e Komitetit Shtetërore për Kultet për zgjidhjen e gjithëpranuar.

Neni 25
Dispozita të fundit

1. Shteti i njeh të drejtën Kryegjyshatës Botërore Bektashiane që të lidhin marrëveshje të veçanta për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje shërben si akt bazë për nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta, me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane, që ratifikohen në Kuvend.

3. Marrëveshjet e veçanta që lidhen me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane në bazë të kësaj Marrëveshjeje, regjistrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Kryegjyshata Botërore Bektashiane mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me anë të denoncimit të Marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend.

Bërë në Tiranë, më 24.10.2008.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Prof. Ylli Pango

PËR KRYEGJYSHATËN BOTËRORE
BAKTASHIANE
KRYEGJYSHI BOTËROR
Haxhi Dede Reshat Bardhi